

VENDIM
Nr. 135, datë 20.3.1997

PËR VLERËSIMIN E DËMEVE TË OBJEKTEVE SHTETËRORE

Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për të bërë një vlerësim sa më real dhe të shpejtë të dëmeve të shkaktuara nga trazirat e kohëve të fundit, ngarkohen të gjitha ministritë dhe institucionet qendrore të marrin masa urgjente për vlerësimin real të dëmeve të shkaktuara si në objekte shtetërore, ashtu edhe në pajisje e aparatura.

Për vlerësimin e dëmeve të mobilizohen specialistët në vartësi të ministrive dhe, kur është e pamundur, edhe specialistë të licencuar me pagesë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.444, datë 5.9.1994.

2. Vlerësimi i shpenzimeve të bëhet për çdo objekt me preventiv, sipas çmimeve në fuqi, veças për objektet dhe veças për pajisjet e aparaturat.

Preventivat do të përfshijnë vetëm shpenzimet për kthimin e objekteve në gjendjen fillestare dhe jo për ndryshime të projekteve bazë.

3. Financimi nga Buxheti i Shtetit i objekteve të dëmtuara bartet në periudhën pasardhëse.

5. Punonjësit e Albtransportit në Tiranë që do të angazhohen me forcat e policisë për ruajtjen e Aeroportit të Rinasit, të shpërblehen deri në trefishin e nivelit ekzistues të pagave.

6. Të gjitha aktet e tjera që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe efektet e tij shtrihen nga data 16.3.1997.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino